REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA

KOMUNA E LIPJANIT
OPŠTINA LIPLJAN
MUNICIPALITY OF LIPJAN

KRYETARI I KOMUNËS

Në mbështetje të nenit 58 pika h.) të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës nr.28 të dates 4 qershor 2008 dhe nenit 40 shkronja h.) të Statutit të Komunës së Lipjanit 15 Nr.110-78095 të datës 24.12.2021, Kryetari i Komunes propozon:

Që duke u bazuar në dispozitat e nenit 12 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës nr. 28 e datës 4 qershor 2008, nenit 20 par.20.1 të Statutit të Komunës së Lipjanit 15 Nr.110-78095 të datës 24.12.2021, nenit 2 paragrafi 4 dhe neni 9 të Rregullores për ndarjen e subvencioneve 15Nr.011-43473 të datës 28.06.2019, Rregullores së Kuvendit së Komunës me Nr.15-110/04-11057 e datës 28.02.2023 për ndryshimin dhe plotësimin e Rregullores për ndarjen e subvencioneve 15Nr.-011-43473 e datës 28.06.2019, Marrëveshjes së Bashkëpunimit Nr.1-413/01-44206 të datës 17.08.2023 e lidhur në mes të Komunës së Lipjanit dhe Islamic Relief Worldwide zyra në Kosovë (IRW), si dhe Aneks Marrëveshjes nr.01-320/01-66307 e datës 01.12.2023, Kuvendi i Komunës në mbledhjen e datës __________2024, të miratojë këtë:

**PROPOZIM**

## V E N D I M
## PËR NDARJEN E MJETEVE FINANCIARE PËR ISLAMIK RELIEF WORLDWIDE – ZYRA NË KOSOVË (IRW)

**I.** MIRATOHET, Vendimi për ndarjen e mjeteve financiare në shumë prej **50.024.00 €** (pesëdhjetë mijë euro e njëzet e katër cent), konform Marrëveshjes së Bashkëpunimit Nr.1-413/01-44206 të datës 17.08.2023, e lidhur në mes të Komunës së Lipjanit dhe Islamic Relief Worldwide zyra në Kosovë (IRW).

**II.** Ndarja e mjeteve të cekura në pikën **I** të këtij Vendimi bëhet me qëllim të përmbushjes së terësishme të obligimeve që rrjedhin nga dispozitat e Marrëveshjes së Bashkëpunimit Nr.1-413/01-44206 të datës 17.08.2023, e lidhur në mes të Komunës së Lipjanit dhe Islamic Relief Worldwide zyra në Kosovë (IRW) me të cilën Komuna e Lipjanit do të participojë 43.87% të vlerës totale përkatësisht kryerjen e obligimeve për pjesën e dytë apo 50% e obligimeve të mbetura .

**III.** Ndarja e mjeteve të cekura bëhet me qëllim të realizimit dhe implementimit të projektit të përbashkët që ka filluar vitin e kaluar dhe vazhdon edhe në vitin 2024 i cili projekt ka për qëllim jetesën e qëndueshme dhe gjenerimin e të ardhurave përmes motokultivatorëve dhe serave ku përfitues nga ky projekt do të jenë banorët e komunës së Lipjanit .

**IV.** Shuma e mjeteve të cekura në pikën **I** të këtij Vendimi do të ndahet nga të hyrat vetanake të Komunës, kategoria ekonomike - subvencione dhe transfere të planifikura për vitin 2024 për Drejtoratin për Bujqësi dhe Pylltari, kodi i programit 47003, fondi burimor 21/613/47003/200/00000/0421.
**V.** Për zbatimin e këtij Vendimi do të kujdeset Drejtorati për Buxhet dhe Financa, dhe Drejtorati për Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural.
**VI.** Vendimi hyn në fuqi 7 ditë pas publikimit në faqen zyrtare të Komunës.

**Arsyetim**

Baza ligjore për miratimin e këtij Propozim - Vendimi është e përcaktuar me dispozitat e nenit 12 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës nr. 28 e datës 4 qershor 2008, nenit 20 par.20.1 të Statutit të Komunës së Lipjanit 15 Nr.110-78095 të datës 24.12.2021, nenit 2 paragrafi 4 dhe neni 9 të Rregullores për ndarjen e subvencioneve 15Nr.011-43473 të datës 28.06.2019, Rregullores së Kuvendit së Komunës me Nr.15-110/04-11057 e datës 28.02.2023 Për Ndryshimin dhe Plotësimin e Rregullores për Ndarjen e Subvencioneve 15Nr.-011-43473 e datës 28.06.2019 dhe Marrëveshjes së Bashkëpunimit Nr.1-413/01-44206 të datës 17.08.2023 e lidhur në mes të Komunës së Lipjanit dhe Islamic Relief Worldwide zyra në Kosovë (IRW).
Ndarja e mjeteve të cekura bëhet me qëllim të realizimit dhe implementimit të projektit të përbashkët që ka filluar vitin e kaluar dhe vazhdon edhe në vitin 2024 i cili projekt ka për qëllim jetesën e qëndueshme dhe gjenerimin e të ardhurave përmes motokultivatorëve dhe serave ku përfitues nga ky projekt do të jenë banorët e Komunës së Lipjanit.
Ndarja e mjeteve të cekura në pikën **I** të këtij Vendimi bëhet me qëllim të përmbushjes së terësishme të obligimeve që rrjedhin nga dispozitat e Marrëveshjes së Bashkëpunimit Nr.1-413/01-44206 të datës 17.08.2023, e lidhur në mes të Komunës së Lipjanit dhe Islamic Relief Worldwide zyra në Kosovë (IRW) me të cilën Komuna e Lipjanit do të participojë 43.87% të vlerës totale përkatësisht kryerjen e obligimeve për pjesën e dytë apo 50% e obligimeve të mbetura .

Nga të cekurat më lartë, kërkojmë nga Kuvendi i Komunës miratimin e këtij Propozim-Vendimi.

1Nr. 400/01-2850
Lipjan, më 12.01.2024

KRYETARI I KOMUNËS
Imri Ahmeti

Komuna Lipjan

Islamic Relief Kosova

# Marrëveshje bashkëpunimi / Agreement

## Ndërmjet / Between

## Islamic Relief Worldwide – Zyra në Kosovë (IRW) / IRW Kosovo Office

## dhe / and

## Komuna Lipjan/ Municipality of Lipjan

| | |
|---|---|
| Për realizimin e projektit humanitar përmes së cilës përcaktohen kushtet mes Islamic Relief Worldwide zyra në Kosovë (IRW) dhe Komuna e Lipjanit në lidhje me bashkimin e mjeteve/fondeve për projektin Përkrahja e fermereve ne Kosove që është pjesë e projektit të IRW me pin kod numër 020_004720 përkrahur nga zyra e Islamic Relief në Switzerland | For the realization of the humanitarian project through the service of conditions between Islamic Relief Worldwide - office in Kosovo (IRW) and the Municipality of Lipjan regarding the join funds / donations for the project Support of agriculture of poor families in Kosova - for the Municipality of Lipjan which is part of the IRW project with pin code number 020_004720 supported by Islamic Relief office in Zvicërr |
| **Neni 1**<br>**Qëllimi i marrëveshjes** | **Article 1**<br>**Purpose of the agreement** |
| 1.1 Qëllimi i kësaj marrëveshje është të përcaktojë formën e bashkëpunimit mes IRW dhe Komunës me qëllim të implementimit dhe finalizimit të projektit që ka për qëllim jetesen e qendrueshme dhe gjenerimin e te ardhurave permes Moto kultivatoreve dhe serave | The purpose of this agreement is to determine the form of cooperation between IRW and the Municipality in order to implement and finalize the project that aims sustainable livelihohod and income generation through Multi cultivators and Greenhouses |
| 1.2 Përfitues nga ky projekt do të jenë të gjithë banoret e Komunës së Lipjansë që llogaritet të jenë rreth 57, 605 banorë. Prej tyre përfitues direkt përafërsisht llogaritet të jenë:<br>199 familje fermeresh<br>95 familje me sera dhe<br>104 moto kultivator | 1.2 Beneficiaries of this project will be all residents of the Municipality of Lipjan which is estimated to be about 57, 605 inhabitants. Of these, the direct beneficiaries are approximately:<br>199 Family farms<br>95 family wih greenhouses<br>104 moto kultivator |

| | |
|---|---|
| 3.2.2 Total vlera e projektit është € 228,044.96 (Dyqind e njezet e tete mije e dyzet e kater euro e nentedhjete e gjashte cent ) | 3.2.2 The total value of the project is € 228,044.96 (Two hundred twenty eight thousand, and fourty four euros and ninety six cent) |
| Neni 4<br>Përgjegjësitë e palëve | Article 4<br>Responsibilities of the parties |
| 4.1 Është e kuptueshme nga të dyja palët nënshkruese të kësaj marrëveshjeje që çdo palë duhet të jetë e aftë për të përmbushur përgjegjësitë sipas kësaj marrëveshjeje. Nëse në çdo kohë komuna nuk është në gjendje të kryejë funksionet e saj sipas Marrëveshjes, menjëherë do të njoftojë IRW - Koordinatoren e Programit si dhe e kundërta. | 4.1 It is understood by both parties to this Agreement that each party must be capable of fulfilling its responsibilities under this Agreement. If at any time the municipality is unable to perform its functions under the Agreement, it shall immediately notify IRW - Program Coordinator and vice versa. |
| 4.2 Të dyja palët bien dakord për të emëruar koordinatorët për zbatimin e suksesshëm të kësaj marrëveshjeje.<br>4.3 Koordinatorët do të jenë përgjegjës për rolet e institucionit të tyre dhe për të siguruar zbatimin e suksesshëm të dispozitave të kësaj marrëveshjeje. | 4.2 Both Parties agree to appoint coordinators for the successful implementation of this Agreement.<br>4.3 The Coordinators shall be responsible for the roles of their Institution and for ensuring the successful implementation of the articles of this Agreement. |
| 4.4 Personi kontaktues i caktuar nga Komuna pranon të jetë përgjegjës për zhvillimin dhe implementimin e kësaj marrëveshjeje si dhe personi kontaktues i caktuar nga IRW pranon të jetë përgjegjës për zhvillimin dhe implementimin e kësaj marrëveshjeje. | 4.4 The Contact Person designated by the Municipality agrees to be responsible for the development and implementation of this Agreement and the Contact Person designated by IRW agrees to be responsible for the development and implementation of this Agreement. |
| Neni 5<br>Koordinatorët | Article 6<br>Coordinators |
| 6.1 Koordinatori për IRW<br>Emri:<br>Adresa: Rruga Bajram Kelmendi, NO. 10/ A<br>Prishtinë, Republika e Kosovës<br>Zyra Telefon: 038/232-431 / | 6.1 IRW Coordinator<br>Name:<br>Address: Bajram Kelmendi Street, NO. 10 / A<br>Pristina, Republic of Kosovo<br>Office Phone: 038/232-431 / |
| 6.2 Koordinatori për Komunë<br>Emri:<br>Adresa:<br>Telefoni:<br>Tel/Fax:<br>Email: | 6.2 Coordinator for the Municipality<br>Name:<br>Address:<br>Phone:<br>Tel / Fax:<br>E-mail: |

ANNEX A

| Participimi | IRW | Lipjan | Total | IRW % | Lipjan % |
|---|---|---|---|---|---|
| Direkt Sera | 77,000.00 | 55,600.00 | 132,600.00 | 58.07% | 41.93% |
| Direkt Motokultivator | 41,250.00 | 36,800.00 | 78,050.00 | 52.85% | 47.15% |
| Indirect Monitoring field visits etc | 9,746.96 | 7,648.00 | 17,394.96 | | |
| Totals: | 127,996.96 | 100,048.00 | 228,044.96 | 56.13% | 43.87% |

REPUBLIKA E KOSOVËS
KOMUNA LIPJAN
REPUBLIKA KOSOVO
OPŠTINA LIPLJAN

| Pranuar me: Primljeno: | 01. 12. 2023 | |
|---|---|---|
| Njësia Jednica | Numri Broj | Shtojca Dodatak |
| 01-320/01-66307 | | |

Komuna e Lipjanit

Islamic Relief Kosova

## Aneks Marrëveshje / Annex Agreement

## Ndërmjet / Between

## Islamic Relief Worldwide – Zyra në Kosovë (IRW) / IRW Kosovo Office

## dhe / and

## Komuna e Lipjanit (Komuna) / Municipality of Lipjan

| | |
|---|---|
| Qëllimi i këtij Aneksi është amandamentimi i Marrëveshjes së bashkëpunimit ndërmjet IRK dhe Komunës së Lipjanit të nënshkruar me datë 17/08/2023, nr Protokollit 01-413/01-44206 | **The purpose of this Annex is to amend the Cooperation Agreement between IRK and the Municipality of Lipjan signed on 17/08/2023, Protocol No. 01-413/01-44206** |
| Për realizimin e projektit humanitar përmes së cilës përcaktohen kushtet mes **Islamic Relief Worldwide zyra në Kosovë (IRW) dhe Komuna e Lipjanit (Komuna)** në lidhje me bashkimin e mjeteve/fondeve për projektin **"Mbështetja e bujqësisë për familjet e varfra në Kosovë"** për Komunën e Lipjanit, që është pjesë e projektit të IRW me pin kod numër **020_004720** përkrahur nga zyra e **Islamic Relief në Zvicër.** Palët që nënshkruan marrëveshjen kryesore lidhin këtë aneks marrëveshje për ndryshimin e pikave si vijon:<br><br>Për arsye të rritjes së numrit të përfituesve në komponentën e motokultivatorëve:<br><br>I. Islamic Relief Kosova ka pranuar ofertë me çmim më të ulët sesa ai që është planifikuar në buxhetin fillestar të këtij projekti | For the realization of the humanitarian project through which the conditions are defined between the **Islamic Relief Worldwide office in Kosovo (IRW)** and the **Municipality of Lipjan (Municipality)** regarding the pooling of means/funds for the project **"Support of agriculture of poor families in Kosova"** for the Municipality of Lipjan, which is part of the IRW project with pin code number **020_004720** supported by the **Islamic Relief office in Swiss.** The parties who signed the main agreement enter into this annex agreement for the changing of the following points:<br><br>Due to the increase in the number of beneficiaries in the moto cultivators component:<br><br>I. Islamic Relief Kosovo has received an offer with lower price than what was planned in the initial budget of this project |

| | |
|---|---|
| II. Çmimi për motokultivator është **319 €** (treqind e nëntëmbëdhjetë euro)<br><br>III. Si rezultat i pranimit të ofertës më të ulët, numri i përfituesve të motokultivatorëve është rritur për 140 (nga 104, në 244 përfitues në total)<br><br>IV. Rritja e numrit të përfituesve të kësaj komponente nuk ndikon në buxhet të projektit apo në implementim të aktiviteteve.<br><br>Ndryshimet dhe plotësimet e bëra me këtë aneks marrëveshje hyjnë në fuqi prej momentit të nënshkrimit të këtij aneksi nga të dy palët kontraktuese. | II. The price for a motor cultivator is 319 € (three hundred and nineteen euros)<br><br>III. As a result of receiving a lower offer, the number of beneficiaries of motor cultivators has been increased for 140 (from 104, to 244 beneficiaries in total)<br><br>IV. The increase in the number of beneficiaries of this component does not affect the project budget or the implementation of activities.<br><br>Changes and additions made to this annex agreement come in into force from the moment of signing of this annex by both contracting parties. |

**Islamic Relief Worldwide – Kosova Office**

**Dr. Mohamed Soliman**

**Country Director Islamic Relief Kosova Municipality**

**Data/Date:** 30 / 11 / 2023

**Komuna e Lipjanit / Municipality of Lipjan**

**Z. Imri Ahmeti**

**Kryetar i Komunës së Lipjanit/ Mayor of Lipjan**

**Data/Date:** 30 / 11 / 2023